



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



TV Dukagjini
Dardan Belegu
Drejtor
Prishtinë

VENDIM



*Lidhur me rastin nr. 2026/190: Artane Rizvanolli (Palë ankuese)
kundër TV Dukagjini (Palë përgjegjëse)*

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) më datën 16 dhjetor 2024 ka miratuar Rregulloren KPM-2024/03 për Obligimet e Ofruesve të Shërbimeve Mediale gjatë Fushatës Zgjedhore, me të cilën janë përcaktuar roli, detyrat dhe përgjegjësitë e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audiovizuale (OSHMA-ve) gjatë fushatës dhe heshtjes zgjedhore në zgjedhjet e përgjithshme dhe ato lokale, të rregullta apo të jashtëzakonshme, të cilat mbahen në Republikën e Kosovës.
2. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) më datën 11 tetor 2016 ka miratuar Kodin e Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës, me të cilin janë përcaktuar rregullat e etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale (OSHMA) në pajtim me dispozitat ligjore që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike.
3. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) me datën 6 qershor 2026 ka pranuar një ankesë nga znj. Artane Rizvanolli, ndaj emisionit "Debat Plus" të transmetuar në TV Dukagjini me datën 5 qershor 2026, me pretendimin se: "Gjatë transmetimit të emisionit të lartcekur, z. Uran Ismaili, në cilësinë e kandidatit për deputet, ka bërë deklaratë publike ndaj meje, Artane Rizvanolli – Ministre e Ekonomisë në detyrë, duke pretenduar ndër të tjera se: "...Veç këta munden me vjedh...", ndërsa në pyetjen e bashkëbiseduesit se "kush ka vjedhur?", i njëjti është përgjigjur: "...Artane Rizvanolli..." Kjo deklaratë përbën një akuzë të drejtpërdrejt dhe të qartë se unë kam vjedhur, akuzë e cila është tërësisht e pavërtetë dhe e bërë pa asnjë bazë faktike apo juridike. Përkundër këtij fakti, deklaratë e paraqet para publikut si të mirëqenë dhe të provuar një pretendim penal ndaj meje, duke krijuar një perceptim të rremë se unë kam kryer veprimtari kriminale dhe duke cenuar rëndë reputacionin, integritetin profesional dhe figurën time publike. Për më tepër, deklaratë është bërë përmes një mediumi me shtrirje të gjerë publike, duke rritur ndjeshëm potencialin e saj për të ndikuar në perceptimin e publikut. Rrethanë veçanërisht rënduese është se deklaratë është publikuar vetëm dy ditë para mbajtjes së zgjedhjeve nacionale, në një periudhë kur interesi i publikut dhe ndikimi i komunikimeve mediale mbi opinionin publik janë në nivelin më të lartë..."
4. KPM me datën 6 qershor 2026 me qëllim të sqarimit të pretendimeve ankimore të Palës ankuese, ka kërkuar nga Pala përgjegjëse që të sjellë sqarim lidhur me ankesën në fjalë. Pala përgjegjëse nuk i është përgjigjur kërkesës së KPM-së.

5. KPM ka analizuar ankesën e Palës ankuese, ka bërë monitorimin e emisionit dhe bazuar në Raportin e monitorimit të datës 8 qershor 2026 ka konstatuar se gjatë debatit në emisionin “Debat Plus” është përdorur gjuhë e papërshtatshme, vulgare dhe ofenduese, nga ana e pjesëmarrësve. Sipas Kodit të Etikës KKPM-2016/03 në emisionet e drejtpërdrejta është obligim i OSHMA-së të ndërmarrë veprimet e duhura për evitimin e kësaj gjuhe. Pala ankuese pretendon se në emisionin “Debat Plus” janë ngrit akuzat nga z. Uran Ismaili si pjesëmarrës në debat përmes të cilave është cenuar reputacioni i saj. KPM, gjen se, përderisa nga pjesëmarrësi në debat nuk janë paraqitur fakte në studio rreth akuzave për vjedhje, është detyrim i moderatorit të kërkojë nga pjesëmarrësit të përmbahen nga kualifikimet me inkriminime penale (përderisa të njëjtat nuk dëshmojnë me fakte), në mënyrë që të shmangët një gjuhë e tillë akuzuese me element ofendimi.
6. KPM me datën 8 qershor 2026 i ka dërguar Palës përgjegjëse Njoftim lidhur me shkeljen e nenit 4, paragrafi 3, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03, si dhe ka njoftuar se bazuar në nenin 7, paragrafi 4, të Rregullores KPM-2024/01, si dhe nenin 20, paragrafi 4, të Rregullores KPM-2024/03, afati i OSHM-së për përgjigje është njëzet e katër (24) orë nga momenti i pranimit të Njoftimit.
7. Pala përgjegjëse është përgjigjur në njoftimin e dërguar nga KPM-së me datë 9 qershor 2026 duke cekur se: *Televizioni Dukagjini njofton se ka pranuar një shkresë nga KPM lidhur me ankesën e Artane Rizvanollit për emisionin “Debat Plus” të datës 5 qershor 2026. Në përgjigjen e saj, TV Dukagjini thekson se shkresa e KPM-së e datës 6 qershor nuk është pranuar në mënyrë të rregullt në adresën zyrtare elektronike të televizionit, gjë që sipas tyre ka ndikuar që përgjigja të mos dorëzohej brenda afatit 24-orësh. Megjithatë, televizioni pohon se në të gjitha rastet e mëparshme gjatë fushatës zgjedhore ka respektuar afatet e përcaktuara për kthimin e përgjigjeve. Sa i përket ankesës, TV Dukagjini argumenton se në debatin në fjalë ka qenë i pranishëm edhe një përfaqësues i Lëvizjes Vetëvendosje, i cili ka paraqitur dhe mbrojtur qëndrimet e partisë dhe të qeverisë. Për këtë arsye, televizioni konsideron se në emision janë përfaqësuar qëndrime të ndryshme politike.*

Analiza ligjore

8. Komisioni i Pavarur i Mediave bazuar në faktet e lartpërmendura konstaton se Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës.
9. Kodi i Etikës KKPM-2016/03, konkretisht neni 4, paragrafi 3, përcakton se:

“Në programet e drejtpërdrejta (debate/intervista etj), është obligim i OSHM-së që të ndërmarrë veprimet e duhura për evitimin e përdorimit të gjuhës vulgare ose ofenduese nga ana e pjesëmarrësve.”
10. KPM konstaton se Pala përgjegjëse ka bërë shkelje të Kodit të Etikës KKPM-2016/03, përkatësisht nenit 4, paragrafi 3, pasi që moderatorit ka dështuar të kërkojë nga pjesëmarrësit të përmbahen nga kualifikimet me inkriminime penale (përderisa të njëjtat nuk dëshmojnë me fakte), në mënyrë që të shmangët një gjuhë e tillë akuzuese me element ofendimi.

11. Gjithashtu duke u bazuar në faktin së pala ankuese pretendon së çështjet e ngritura në emisionin “Debat Plus” janë të pavërteta dhe shqetësuese, Pala Përgjegjëse obligohet që palës ankuese t’i ofrojë të drejtën e paraqitjes së pikëpamjeve të sajë për t’i kundërshtuar pretendimet e ngritura në emision, ashtu siç përcaktohet me nenin 10, paragrafi 2, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03, i cili përcakton se:

“ Çdo person, pa dallim shtetësie ose vendbanimi, që përmendet në një ofrues të shërbimit medial për të cilin faktet janë bërë të disponueshme për publikun te cilat ai i deklaron që janë të pasakta, mund te ushtrojë të drejtën e reagimit për të korrigjuar faktet që shqetësojnë atë person”.

12. Ndërsa nenin 10, paragrafi 1, i Kodit të Etikës KKPM-2016/03, në lidhje më këtë çështje, përcakton se:

“Me qëllim të korrektësisë dhe paanshmërisë duhet te ofrohet mundësia që brenda shtatë (7) ditësh pas paraqitjes së ankesës së individit apo organizatës, të transmetohet reagimi përkatës në mediumin e njëjtë. Reagimi duhet të transmetohet në kohë dhe hapësirë te njëjte”.

Vendim

13. Pala përgjegjëse sanksionohet me **Vërejtje** në pajtim me nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së, për shkelje të nenit 4, paragrafi 3, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03;
14. Pala përgjegjëse udhëzohet që, pas pranimit të këtij vendimi, në pajtim me nenin 30, paragrafi 1, pika 2 të Ligjit të KPM-së, të shpreh mospajtimin (keqardhjen) për lejimin e përdorimit të gjuhës ofenduese në programin televiziv Debat Plus;
15. Pala përgjegjëse gjithashtu obligohet që brenda shtatë (7) ditëve, pas pranimit të Vendimit, t’i ofrojë të drejtën e reagimit Palës ankuese, siç përcaktohet me nenin 10, paragrafi 1 dhe 2, të Kodit të Etikës KKPM-20216/03.

E drejta për Ankesë

16. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
17. Bordi për Ankesa do t’i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.


Besnik Berisha

Kryetar i Komisionit të Pavarur për Media



10.06.2026
Datë



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



TV Syri Vision
Janina Zherka
Drejtoreshë
Gjakovë

VENDIM



Lidhur me rastet 2026/180 dhe 2026/185: Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për Ofruesin e Shërbimit Medial Audiovizual TV Syri Vision (Palë përgjegjëse)

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) më datën 16 dhjetor 2024 ka miratuar Rregulloren KPM-2024/03 për Obligimet e Ofruesve të Shërbimeve Mediale gjatë Fushatës Zgjedhore, me të cilën janë përcaktuar roli, detyrat dhe përgjegjësitë e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audiovizuale (OSHMA-ve) gjatë fushatës dhe heshtjes zgjedhore në zgjedhjet e përgjithshme dhe ato lokale, të rregullta apo të jashtëzakonshme, të cilat mbahen në Republikën e Kosovës.
2. Me datën 18 maj 2026 KPM i ka publikuar dhe i ka dërguar Palës përgjegjëse Rregulloren KPM-2024/03, letrën sqaruese, si dhe Ditarët A dhe B pa pagesë dhe me pagesë, me qëllim të njoftimit të të licencuarve me Rregulloren KPM-2024/03 dhe aktet tjera nënligjore të KPM-së.
3. KPM me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së Palës përgjegjëse me Rregulloren KPM-2024/03 për Obligimet e Ofruesve të Shërbimeve Mediale gjatë Fushatës Zgjedhore, ka iniciuar monitorimin e përmbajtjeve programore të transmetuara nga Pala përgjegjëse me datën 7 qershor 2026 në ditën e zgjedhjeve, konkretisht në heshtjen zgjedhor.
4. Në bazë të Raportit të monitorimit të datës 7 qershor 2026 është konstatuar se Pala përgjegjëse me datë 7 qershor 2026, ka transmetuar në ora 11:30 min, intervistën të znj. Vjosa Osmani e cila është kandidate për deputete në listën e subjektit të certifikuar politik LDK, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 14, paragrafi 4, të Rregullores KPM-2024/03 për Obligimet e Ofruesve të Shërbimeve Mediale gjatë Fushatës Zgjedhore.
5. KPM me datën 7 qershor 2026 i ka dërguar Palës përgjegjëse Njoftim lidhur me shkeljet e nenit 14, paragrafi 4, të Rregullores KPM-2024/03, përmes të cilit e ka udhëzuar të ndërmarrë masat e duhura që shkeljet e tilla mos të përsëriten gjatë ditës së zgjedhjeve për të vepruar menjëherë në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2024/03, si dhe aktet tjera nënligjore të KPM-së gjatë heshtjes zgjedhore në Republikën e Kosovës. Po ashtu, e ka njoftuar se bazuar në nenin 7, paragrafi 4, të Rregullores KPM-2024/01, si dhe nenin 20, paragrafi 4, të Rregullores KPM-2024/03, afati i OSHM-së për përgjigje është njëzet e katër (24) orë nga momenti i pranimit të Njoftimit.

6. KPM me datë 7 qershor 2026 ka pranuar përgjigje nga Pala përgjegjëse duke cekur se: *"Përsëritje E kemi pranuar emailin tuaj dhe ju falënderojmë për rikujtimin Menjëherë do ta largojmë materialin në fjale dhe do ta përmirësojmë gabimin. Faleminderit për mirëkuptim!"*.
7. Në bazë të Raportit të monitorimit të datës 7 qershor 2026 është konstatuar se Pala përgjegjëse me datë 7 qershor 2026, rreth orës 13:21, është evidentuar se është transmetuar një prononcim i z. Hajdar Beqa, kandidat për deputet nga Partia Demokratike e Kosovës, në orën 13:22, është evidentuar se është transmetuar një prononcim i z. Agon Batusha, kandidat për deputet nga Lëvizja Vetëvendosje. Po ashtu në orën 13:22 është transmetuar një prononcim i z. Shefqet Shehu, kandidat për deputet nga LDK, veprime këto që bien në kundërshtim me nenin 14, paragrafi 4, të Rregullores KPM-2024/03 për Obligimet e Ofruesve të Shërbimeve Mediale gjatë Fushatës Zgjedhore.
8. KPM me datën 7 qershor 2026 i ka dërguar Palës përgjegjëse Njoftim lidhur me shkeljet e nenit 14, paragrafi 4, të Rregullores KPM-2024/03, përmes të cilit e ka udhëzuar të ndërmarrë masat e duhura që shkeljet e tilla mos të përsëriten gjatë ditës së zgjedhjeve për të vepruar menjëherë në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2024/03, si dhe aktet tjera nënligjore të KPM-së gjatë heshtjes zgjedhore në Republikën e Kosovës. Po ashtu, e ka njoftuar se bazuar në nenin 7, paragrafi 4, të Rregullores KPM-2024/01, si dhe nenin 20, paragrafi 4, të Rregullores KPM-2024/03, afati i OSHM-së për përgjigje është njëzet e katër (24) orë nga momenti i pranimit të Njoftimit.
9. KPM me datë 7 qershor 2026 ka pranuar përgjigje nga Pala përgjegjëse duke cekur se: *Ne personat në fjale i kemi transmetuar për shkak që të njëjtit janë liderë të partive politike të degëve në Gjakovë. Megjithatë, nëse ju vlerësoni se transmetimi i prononcimeve të tyre është i ndaluar, ju lutem te na njoftoni dhe ne menjëherë do ti largojmë materialet në fjale."*

Analiza ligjore

10. Komisioni i Pavarur i Mediave bazuar në faktet e lartpërmendura konstaton se Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me Rregulloren KPM-2024/03 për Obligimet e Ofruesve të Shërbimeve Mediale gjatë Fushatës Zgjedhore.
11. KPM ka konstatuar se Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim e nenin 14, paragrafi 4, të Rregullores KPM-2024/03, i cili përcakton se:
"OSHM-të gjatë ditës së zgjedhjeve dhe deri në mbylljen e vendvotimeve nuk transmetojnë prononcimet e kandidatëve nga listat për deputetë apo asamblast më përjashtim të liderëve të partive politike dhe kandidatëve për kryeministër apo kryetar të komunës."
12. Prandaj, KPM duke u bazuar në faktet e lartpërmendura ka konstatuar se Pala përgjegjëse ka bërë shkelje të nenin 14, paragrafi 4, të Rregullores KPM-2024/03 ka transmetuar në ora 11:30 min, intervistën të znj. Vjosa Osmani e cila është kandidate për deputete në listën e subjektit të certifikuar politik LDK, gjithashtu rreth orës 13:21, është evidentuar se është transmetuar një prononcim i z. Hajdar Beqa, kandidat për deputet nga Partia Demokratike e Kosovës, në orën 13:22, është evidentuar se është transmetuar një prononcim i z. Agon Batusha, kandidat për deputet nga Lëvizja Vetëvendosje. Po ashtu në orën 13:22 është transmetuar një prononcim i z. Shefqet Shehu, kandidat për deputet nga LDK.

Vendim

13. Pala përgjegjëse sanksionohet me **Vërejtje** në pajtim me nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së, për shkelje të nenit 14, paragrafi 4, të Rregullores KPM-2024/03.
14. Pala përgjegjëse obligohet që në të ardhmen të ndërmarrë veprime konkrete për të vepruar në pajtim me Rregulloren KPM-2024/03.

E drejta për ankesë

15. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
16. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.


Besnik Berisha
Kryetar i Komisionit të Pavarur për Media




10.06.2026
Datë



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Kanal 10
Arben Ahmeti
Drejtör
Prishtinë



VENDIM

Lidhur me rastet nr. 2026/178, 2026/187: Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për Ofruesin e Shërbimit Medial Audiovizual Kanal 10 (Palë përgjegjëse)

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) më datën 16 dhjetor 2024 ka miratuar Rregulloren KPM-2024/03 për Obligimet e Ofruesve të Shërbimeve Mediale gjatë Fushatës Zgjedhore, me të cilën janë përcaktuar roli, detyrat dhe përgjegjësitë e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audiovizuale (OSHMA-ve) gjatë fushatës dhe heshtjes zgjedhore në zgjedhjet e përgjithshme dhe ato lokale, të rregullta apo të jashtëzakonshme, të cilat mbahen në Republikën e Kosovës.
2. KPM, ka bërë monitorimin e Palës përgjegjëse për të vlerësuar pajtueshmërinë me Rregulloren KPM-2024/03 për Obligimet e Ofruesve të Shërbimeve Mediale gjatë Fushatës Zgjedhore dhe aktet nënligjore të KPM-së gjatë procesit të fushatës dhe heshtjes zgjedhore në Zgjedhjet e Përgjithshme, që do të mbahen me datën 7 qershor 2026 në Republikën e Kosovës.
3. Me datën 18 maj 2026, KPM i ka publikuar dhe dërguar Palës përgjegjëse Rregulloren KPM-2024/03, letrën sqaruese, Ditarët A dhe B me pagesë dhe pa pagesë, me qëllim të njoftimit të të licencuarve me Rregulloren KPM-2024/03 dhe aktet tjera nënligjore të KPM-së.
4. Në bazë të Raportit të monitorimit të datës 7 qershor 2026 është konstatuar se Pala përgjegjëse me datën 3 qershor 2026 ka transmetuar në ora 10:12 intervistën e znj. Vjosa Osmani, kandidate për deputete në listën e subjektit të certifikuar politik LDK, duke vepruar në kundërshtim me nenin 14, paragrafi 4, të Rregullores KPM-2024/03.
5. KPM me datën 7 qershor 2026 i ka dërguar Palës përgjegjëse Njoftim lidhur me shkeljet e lartpërmendura, përmes të cilit e ka udhëzuar që të veprojë në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2024/03, si dhe aktet tjera nënligjore të KPM-së gjatë procesit të fushatës zgjedhore në Republikën e Kosovës. Po ashtu duke e njoftuar për afatin njëzet e katër (24) orë për përgjigje, bazuar në nenin 7, paragrafi 4, të Rregullores KPM-2024/01, si dhe nenin 20, paragrafi 4, të Rregullores KPM-2024/03.
6. Pala përgjegjëse është përgjigjur në njoftimin e dërguar nga KPM.
7. Po ashtu, në bazë të Raportit të monitorimit të datës 7 qershor 2026 është konstatuar se Pala përgjegjëse me datën 7 qershor 2026, rreth orës 12:13, ka transmetuar një prononcim i z. Faton Peci, Kryetari i Komunës së Mitrovicës së jugut, duke vepruar në kundërshtim me nenin 14, paragrafi 4, të Rregullores KPM-2024/03 për Obligimet e Ofruesve të Shërbimeve Mediale gjatë Fushatës Zgjedhore.

8. KPM me datën 7 qershor 2026 i ka dërguar Palës përgjegjëse Njoftim lidhur me shkeljen e lartpërmendur, përmes të cilit e ka duke e udhëzuar që të veprojë në pajtueshmëri me nenin 14, paragrafi 4, të Rregullores KPM-2024/03, si dhe aktet tjera nënligjore të KPM-së gjatë procesit të fushatës zgjedhore në Republikën e Kosovës. Po ashtu, duke e njoftuar për afatin njëzet e katër (24) orë për përgjigje, bazuar në nenin 7, paragrafi 4, të Rregullores KPM-2024/01, si dhe nenin 20, paragrafi 4, të Rregullores KPM-2024/03.
9. Pala përgjegjëse nuk është përgjigjur në njoftimin e dërguar nga e KPM.

Analiza ligjore


10. Komisionit i Pavarur Mediave bazuar në faktet e lartpërmendura konstaton se Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me Rregulloren KPM-2024/03 për Obligimet e Ofruesve të Shërbimeve Mediale gjatë Fushatës Zgjedhore.
11. KPM ka konstatuar se Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 14, paragrafi 4, të Rregullores KPM-2024/03, i cili përcakton se:
- “OSHM-të gjatë ditës së zgjedhjeve dhe deri në mbylljen e vendotimeve nuk transmetojnë prononcimet e kandidatëve nga listat për deputetë apo asamblist më përjashtim të liderëve të partive politike dhe kandidatëve për kryeministër apo kryetar të komunës.”*
12. Prandaj, KPM duke u bazuar në faktet e lartpërmendura ka konstatuar se Pala përgjegjëse ka bërë shkelje të Rregullores KPM-2024/03, përkatësisht nenit 14, paragrafi 4, duke transmetuar prononcimin e znj. Vjosa Osmani, kandidate për deputete dhe prononcimin z. Faton Peci, Kryetari i Komunës së Mitrovicës së jugut. Duke u bazuar në faktin se zgjedhjet janë të përgjithshme (jo lokale), edhe pronocimi i kryetarëve të komunave nuk është në pajtim me nenin 14, paragrafi 4 të Rregullores KPM-2024/03.

Vendim

13. Pala përgjegjëse sanksionohet me **Vërejtje** në pajtim me nenin 30, paragrafi 1 të Ligjit të KPM-së, për shkelje të nenit 14, paragrafi 4, të Rregullores KPM-2024/03,
14. Pala përgjegjëse obligohet që në të ardhmen të ndërmarrë veprime konkrete për të vepruar në pajtim me Rregulloren KPM-2024/03.

E drejta për ankesë

15. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
16. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërisht relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.


Besnik Berisha

Kryetar i Komisionit të Pavarur për Media



10.06.2026
Datë



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



TËVË 1

Mehmet Kalisi

Drejtör

Prishtinë

VENDIM



Lidhur me rastin nr. 2026/186: Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për Ofruesin e Shërbimit Medial Audiovizual TËVË 1 (Palë përgjegjëse)

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) më datën 16 dhjetor 2024 ka miratuar Rregulloren KPM-2024/03 për Obligimet e Ofruesve të Shërbimeve Mediale gjatë Fushatës Zgjedhore, me të cilën janë përcaktuar roli, detyrat dhe përgjegjësitë e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audiovizuale (OSHMA-ve) gjatë fushatës dhe heshtjes zgjedhore në zgjedhjet e përgjithshme dhe ato lokale, të rregullta apo të jashtëzakonshme, të cilat mbahen në Republikën e Kosovës.
2. KPM, ka bërë monitorimin e Palës përgjegjëse për të vlerësuar pajtueshmërinë me Rregulloren KPM-2024/03 për Obligimet e Ofruesve të Shërbimeve Mediale gjatë Fushatës Zgjedhore dhe aktet nënligjore të KPM-së gjatë procesit të fushatës dhe heshtjes zgjedhore në Zgjedhjet e Përgjithshme, që do të mbahen me datën 7 qershor 2026 në Republikën e Kosovës.
3. Me datën 18 maj 2026, KPM-së i ka publikuar dhe dërguar Palës përgjegjëse Rregulloren KPM-2024/03, letrën sqaruese, Ditarët A dhe B me pagesë dhe pa pagesë, me qëllim të njoftimit të të licencuarve me Rregulloren KPM-2024/03 dhe aktet tjera nënligjore të KPM-së.
4. Në bazë të Raportit të monitorimit të datës 7 qershor 2026 është konstatuar se Pala përgjegjëse me datë 7 qershor 2026 se ka transmetuar prononcimin e z. Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës së Podujevës, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 14, paragrafi 4, të Rregullores KPM-2024/03 për Obligimet e Ofruesve të Shërbimeve Mediale gjatë Fushatës Zgjedhore.
5. KPM me datën 7 qershor 2026 i ka dërguar Palës përgjegjëse Njoftim lidhur me shkeljet e nenit 14, paragrafi 4, të Rregullores KPM-2024/03, përmes të cilit e ka udhëzuar të ndërmarrë masat e duhura që shkeljet e tilla mos të përsëriten gjatë ditës së zgjedhjeve për të vepruar menjëherë në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2024/03, si dhe aktet tjera nënligjore të KPM-së gjatë heshtjes zgjedhore në Republikën e Kosovës. Po ashtu, e ka njoftuar se bazuar në nenin 7, paragrafi 4, të Rregullores KPM-2024/01, si dhe nenin 20, paragrafi 4, të

Rregullores KPM-2024/03, afati i OSHM-së për përgjigje është njëzet e katër (24) orë nga momenti i pranimit të Njoftimit.

6. Pala përgjegjëse nuk është përgjigjur në njoftimin e dërguar nga KPM-së.

Analiza ligjore

7. Komisioni i Pavarur i Mediave bazuar në faktet e lartpërmendura konstaton se Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me Rregulloren KPM-2024/03 për Obligimet e Ofruesve të Shërbimeve Mediale gjatë Fushatës Zgjedhore.
8. KPM ka konstatuar se Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim e nenin 14, paragrafi 4, të Rregullores KPM-2024/03, i cili përcakton se:

“OSHM-të gjatë ditës së zgjedhjeve dhe deri në mbylljen e vendotimeve nuk transmetojnë prononcimet e kandidatëve nga listat për deputetë apo asamblast më përjashtim të liderëve të partive politike dhe kandidatëve për kryeministër apo kryetar të komunës.”


9. Prandaj, KPM duke u bazuar në faktet e lartpërmendura ka konstatuar se Pala përgjegjëse ka bërë shkelje të nenin 14, paragrafi 4, të Rregullores KPM-2024/03, duke transmetuar prononcimin e z. Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës së Podujevës. Duke u bazuar në faktin se zgjedhjet janë të përgjithshme (jo lokale), prononcimi i kryetarëve të komunave nuk është në pajtim me nenin 14, paragrafi 4, të Rregullores KPM-2024/03.

Vendim

10. Pala përgjegjëse sanksionohet me **Vërejtje** në pajtim me nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së, për shkelje të nenit 14, paragrafi 4, të Rregullores KPM-2024/03.
11. Pala përgjegjëse obligohet që në të ardhmen të ndërmarrë veprime konkrete për të vepruar në pajtim me Rregulloren KPM-2024/03.

E drejta për ankesë

12. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
13. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërisht relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.



Besnik Berisha
Kryetar i Komisionit të Pavarur për Media




10.06.2026

Datë



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Klan Kosova
Barlet Imami
Drejtör
Prishtinë

VENDIM



Lidhur me rastet nr. 2026/177, 2026/181: Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për Ofruesin e Shërbimit Medial Audiovizual Klan Kosova (Palë përgjegjëse)

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) më datën 16 dhjetor 2024 ka miratuar Rregulloren KPM-2024/03 për Obligimet e Ofruesve të Shërbimeve Mediale gjatë Fushatës Zgjedhore, me të cilën janë përcaktuar roli, detyrat dhe përgjegjësitë e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audiovizuale (OSHMA-ve) gjatë fushatës dhe heshtjes zgjedhore në zgjedhjet e përgjithshme dhe ato lokale, të rregullta apo të jashtëzakonshme, të cilat mbahen në Republikën e Kosovës.
1. Zyra Ekzekutive e KPM-së ka bërë monitorimin e Palës përgjegjëse për të vlerësuar pajtueshmërinë me Rregulloren KPM-2024/03 për Obligimet e Ofruesve të Shërbimeve Mediale gjatë Fushatës Zgjedhore dhe aktet nënligjore të KPM-së gjatë procesit të fushatës dhe heshtjes zgjedhore në Zgjedhjet e Përgjithshme, që u mbajtën me datën 7 qershor 2026 në Republikën e Kosovës. [Shtojca 2]
2. Në bazë të Raportit të monitorimit të datës 7 qershor 2026 është gjetur se Pala përgjegjëse në ditën e zgjedhjeve, me 7 qershor 2026, ka transmetuar në ora 9:53, si dhe e ka ritransmetuar në ora 10:27 intervistën e znj. Vjosa Osmani, kandidate për deputete në listën e subjektit të certifikuar politik LDK, veprim ky i cili bie në kundërshtim me nenin 14, paragrafi 4, të Rregullores KPM-2024/03 për Obligimet e Ofruesve të Shërbimeve Mediale gjatë Fushatës Zgjedhore.
3. KPM me datën 7 qershor 2026 i ka dërguar Palës përgjegjëse Njoftim lidhur me shkeljen e nenit 14, paragrafi 4, të Rregullores KPM-2024/03, përmes të cilit e ka udhëzuar të ndërmarrë masat e duhura që shkeljet e tilla mos të përsëriten gjatë ditës së zgjedhjeve, për të vepruar menjëherë në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2024/03, si dhe aktet tjera nënligjore të KPM-së gjatë heshtjes zgjedhore në Republikën e Kosovës. Po ashtu, e ka njoftuar se bazuar në nenin 7, paragrafi 4, të Rregullores KPM-2024/01, si dhe nenin 20, paragrafi 4, të Rregullores KPM-2024/03, afati i OSHM-së për përgjigje është njëzet e katër (24) orë nga momenti i pranimit të Njoftimit.
4. KPM me datë 7 qershor 2026 ka pranuar përgjigje nga Pala përgjegjëse duke cekur se: “Së pari, neni 14 paragrafi 4 i Rregullores KPM-2024/03 ndalon transmetimin e prononcimeve të kandidatëve nga listat për deputetë apo asamleistë, me përjashtim të liderëve të partive

politike dhe kandidatëve për kryeministër apo kryetar komune. Qëllimi i kësaj dispozite është të shmangë favorizimin e kandidatëve individualë gjatë ditës së zgjedhjeve dhe të ruajë barazinë ndërmjet garuesve në procesin zgjedhor. Megjithatë, në rastin konkret, znj. Vjosa Osmani nuk është intervistuar në cilësisë e një kandidateje për deputete, ajo është paraqitur në cilësinë e saj si figurë politike dhe bartëse e listës së subjektit politik përkatës. As Rregullorja KPM-2024/03 dhe as ndonjë dispozitë tjetër ligjore në fuqi nuk përmbajnë ndalim për transmetimin e prononcimeve të bartësve të listave zgjedhore. Në interpretimin e normave kufizuese që prekin lirinë e medias dhe lirinë e shprehjes, vlen parimi themelor juridik se kufizimet duhet të interpretohen ngushtë dhe nuk mund të zgjerohen përtej asaj që është shprehimisht e përcaktuar në normë. Rrjedhimisht, nëse rregullatori ka zgjedhur të ndalojë vetëm prononcimet e kandidatëve për deputetë dhe asambleistë, ai nuk mund ta zgjerojë këtë ndalim për kategori të tjera personash që nuk përfshihen shprehimisht në tekstin normativ. Një interpretim i tillë do të ishte në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike dhe të para shikueshmërisë së normave administrative. Për më tepër, vetë dispozita e nenit 14 paragrafi 4 përmban përjashtime eksplicite për liderët e partive politike, kandidatët për kryeministër dhe kandidatët për kryetar komune, duke dëshmuar se rregullatori ka synuar të lejojë raportimin dhe transmetimin e deklaratave të figurave politike që përfaqësojnë subjektet politike në nivel institucional dhe politik. Në këtë kontekst, trajtimi i bartësve të listave si kategori e ndaluar pa një bazë të qartë normative do të përbënte interpretim analog të një dispozite kufizuese, gjë që është juridikisht e papranueshme...”

5. Po ashtu, KPM në bazë të Raportit tjetër të monitorimit të datës 7 qershor 2026, ka gjetur se Pala përgjegjëse në ditën e zgjedhjeve me 7 qershor 2026 ka transmetuar, prononcimin e z. Përparim Rama, Kryetar i Komunës së Prishtinës rreth orës 10:41, si dhe prononcimet e z. Faton Peci, Kryetar i Komunës së Mitrovicës dhe z. Shaqir Totaj, Kryetar i Komunës së Prizrenit rreth orës 10:10, veprime këto që bien në kundërshtim me nenin 14, paragrafi 4, të Rregullores KPM-2024/03.
6. KPM me datën 7 qershor 2026 i ka dërguar Palës përgjegjëse Njoftim lidhur me shkeljen e nenit 14, paragrafi 4, të Rregullores KPM-2024/03, përmes të cilit e ka udhëzuar të ndërmarrë masat e duhura që shkeljet e tilla mos të përsëriten gjatë ditës së zgjedhjeve, për të vepruar menjëherë në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2024/03, si dhe aktet tjera nënligjore të KPM-së gjatë heshtjes zgjedhore në Republikën e Kosovës. Po ashtu, e ka njoftuar se bazuar në nenin 7, paragrafi 4, të Rregullores KPM-2024/01, si dhe nenin 20, paragrafi 4, të Rregullores KPM-2024/03, afati i OSHM-së për përgjigje është njëzet e katër (24) orë nga momenti i pranimit të Njoftimit.
7. KPM me datë 9 qershor 2026 ka pranuar përgjigje nga Pala përgjegjëse duke cekur se: *“Personat e përmendur në shkresën tuaj nuk janë trajtuar në cilësinë e kandidatëve për deputetë apo asambleistë, por në cilësinë e kryetarëve të komunës, kategori e cila sipas vetë tekstit të dispozitës është e përjashtuar nga ndalimi. Për më tepër, prononcimet e transmetuara kanë qenë deklarime informative lidhur me procesin zgjedhor dhe zhvillimet e ditës së zgjedhjeve dhe thirrje për pjesëmarrje në zgjedhje, që e cila cilësohet si mesazh inkurajues sidomos në rastet kur ka pas dalje të vogël në zgjedhje, dhe jo e kundërta. Ato nuk kanë përmbajtur thirrje për votim, kërkesë për mbështetje elektorale, promovim programi apo mesazh të natyrës propaganduese që do të mund të konsideroheshin aktivitet fushate. Interpretimi sipas të cilit çdo paraqitje publike e një kandidati për kryetar komune gjatë ditës së zgjedhjeve do të përbënte automatikisht shkelje të heshtjes zgjedhore, jo vetëm që nuk*

rrjedh nga dispozita e cituar, por do të cenonte në mënyrë të pajustificueshme të drejtën e publikut për informim dhe të drejtën e mediave për raportim mbi ngjarjet me interes publik.”

Analiza ligjore

8. Komisionit i Pavarur Mediave bazuar në faktet e lartpërmendura konstaton se Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me Rregulloren KPM-2024/03 për Obligimet e Ofruesve të Shërbimeve Mediale gjatë Fushatës Zgjedhore.
9. KPM ka gjetur se Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 14, paragrafi 4, të Rregullores KPM-2024/03, i cili përcakton se:

“OSHM-të gjatë ditës së zgjedhjeve dhe deri në mbylljen e vendotimeve nuk transmetojnë prononcimet e kandidatëve nga listat për deputetë apo asamblist më përjashtim të liderëve të partive politike dhe kandidatëve për kryeministër apo kryetar të komunës.”

10. Prandaj, KPM- duke u bazuar në faktet e lartpërmendura ka gjetur se Pala përgjegjëse ka bërë shkelje të nenin 14, paragrafi 4, të Rregullores KPM-2024/03, duke transmetuar prononcimet e kandidatëve për deputetë si dhe kryetarëve të komunave të Kosovës. Duke u bazuar në faktin se zgjedhjet janë të përgjithshme (jo lokale), edhe prononcimi i kryetarëve të komunave nuk është në pajtim me nenin 14, paragrafi 4, të Rregullores KPM-2024/03.

Vendim

11. Pala përgjegjëse sanksionohet me **Vërejtje** në pajtim me nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së, për shkelje të nenit 14, paragrafi 4, të Rregullores KPM-2024/03.
12. Pala përgjegjëse obligohet që në të ardhmen të ndër marrë veprime konkrete për të vepruar në pajtim me Rregulloren KPM-2024/03.

E drejta për ankesë

13. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkojnë nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
14. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.


Besnik Berisha

Kryetar i Komisionit të Pavarur për Media



10.06.2026

Datë